



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Zyra e Kuvendit

Nr. 31-5344

Drenas, 18.04.2012



Në mbështetje të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Rregullores së punës së Kuvendit të Drenasit, Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të rregullt të mbajtur më dt. 30.03.2012 mori këtë:

V E N D I M

1.

APROVOHET Raporti Financiar i Komunës për vitin 2011.

2.

Raporti Financiar i Komunës së Drenasit për vitin 2011 i paraqitur nga Kryetari i Komunës z. Nexhat Demaku u aprovua nga Kuvendi pas një debati të gjerë të Këshilltarëve të Kuvendit të Komunës.

3.

Ky Raport përfshin të hyrat dhe shpenzimet e mjeteve financiare për periudhën prej 01.01.2011 deri më 31.12.2011.

4.

Aprovimi i këtij raporti përmbush obligimet ligjore të Rregullativës së përmendur në preambulën e këtij Vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1x1 Zyrës së Kryetarit

1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

1x1 Arkivit të Kuvendit



Kryetari i Kuvendit:

Atmir Istogu/